



Autoriteti Menaxhues

*Situata aktuale e fushatës së
informimit për thirrjen e parë për
aplikime*

19 Mars 2019

I. Aktivitete të realizuara gjatë hapjes së thirrjes së parë për aplikim

Më 26 tetor 2018, Ambasadori i Delegacionit të BE-së në Tiranë, në mënyrë zyrtare, i dorëzoi Kryeministrit të Shqipërisë, letrën e marrjes së besimit për hapjen e thirrjes së parë për aplikime.

AM dhe Agjencia IPARD, në bashkëpunim të ngushtë kanë përgatitur dokumentat e mëposhtme:

1. AM përgatiti Termat e Referencës për 2 procedura tenderimi:
 - Spotet TV dhe radios;
 - Specifikimet teknike për printimin e materialeve informuese;
2. Përgatitja dhe publikimi i Njoftimit Paraprak (një muaj përpara hapjes së thirrjes e vlefshme edhe në faqen web të MBZHR dhe Agjencisë IPARD);
3. Përgatitja e planit për fushatën e informimit (kalendari kohor për IPARD II si dhe kalendari i aktiviteteve);
4. Publikimi i Udhëzuesit për aplikantët me akenset dhe aktivitetet e tjera në faqet zyrtare respektive të MBZHR dhe Agjencisë IPARD;
5. Përgatitja e Planit të Veprimit për thirrjen e parë për aplikime (përcaktimi i përgjegjësive të secilit institucion përfshirë në këtë proces);
6. GIZ mbështeti MBZHR në organizimin e 5 moduleve të trajnimit për 5 ditë secili me një total prej 155 persona, kryesisht për Shërbimin Këshillimor Publik dhe privat si dhe palët e tjera të interesuara;
7. Gjithashtu GIZ mbështeti financiarisht MBZHR lidhur me transmetimin e spoteve TV dhe të radios;
8. AM përgatiti minutat e takimit dhe pyetjet kryesore të ngritura gjatë eventeve.

II. Ditët rajonale të informimit

Eventet rajonale (12- 27 Nëntor 2018):

- 1 konferencë kombëtare në Tiranë;
- 11 evente informuese rajonale;

Numri total i pjesëmarrësve ishte rreth 1200 pjesëmarrës nga të cilët:

- 582 fermerë;
- 123 agro përpunues
- 373 të tjerë të interesuar për të aplikuar;

Pyetjet e ngritura gjatë fushatës informuese:

- Afërsisht 160 pyetje të përgjithshme për të 3 masat ku 38 ishin më të shpeshta (përsëritje).


Përgatitja e pyetsorëve dhe shpërndarja tek pjesmarrësit:

256 pyetsorë të plotësuar, nga të cilët:

- 231 persona treguan interes, 11 persona ishin ende të pasigurtë, 3 persona nuk ishin të interesuar, si dhe 11 nuk kanë të drejtë të aplikojnë
- 185 pyetsorë u plotësuan nga fermerët dhe 27 agro-përpunuesit;
- Interes i lartë për të aplikuar u tregua në rajonet e Shkodrës, Fierit, Dibrës, Kukësit, Elbasanit dhe Lezhës (grafiku si më poshtë).

III. Të dhëna nga pyetësorët

Numri i pjesëmarrësve të interesuar për të aplikuar më skemën grant të IPARD



IV. Të dhëna nga pyetësorët

Interesi për të aplikuar bazuar në masë/ sektor:

▪ Masa 1:

- 65 të interesuar për sektorin e frutave & perimeve;
- 50 të interesuar ne sektorin e qumështit dhe;
- 33 të interesuar në sektorin e mishit.

▪ Masa 3:

- 32 të interesuar në përpunimin e frutave & perimeve.

▪ Masa 7:

- 30 të interesuar në prodhimin e BAM-ve, kërpudha, mjalt, bimët dekorative dhe kërmijtë;
- 30 të interesuar në përpunimin dhe tregëtimin i BAM-ve të egra ose të kultivuara ,kërpudha dhe mjalt dhe;
- 27 të interesuar për natyrën në masën natyra dhe turizmi rural.

V. Të dhëna nga pyetsorët

Numri i aplikantëve të interesuar për të aplikuar bazuar sipas sektorëve/masave

Nr.	Rajoni	Masa 1				Masa 3				Masa 7							
		M 1- Qumesht	M1- Mish	M1- Fruta&Perime	M1-Vresht	M 3- Qumesht	M3- Mish	M3- Fruta&Perime	M3-Vera	M7-Prodhimi i bimëve aromatike mjekësore (BAM), kerpudhave, mjaltit, bimëve zbukuruese dhe kërmjive	M7-Përpunimi dhe tregtimi i produkteve bujqësore në fermë	M7- Përpunimi dhe tregtimi i bimëve medicinale dhe aromatike të egra apo të kultivuara, kerpudha dhe mjaltë	M7-Akuakultura	M7-Natyrë dhe turizmi rural	M7-Shërbime për popullsinë dhe bizneset rurale	M7-Industria e artizanatit dhe punishtet e prodhimit	M7-Prodhimi dhe përdorimi i energjisë së rinovueshme
1	Tirana	4	2	0	1	5	2	1	1	3	2	5	0	2	0	0	0
2	Berat	0	0	1	0	0	0	1	0	0	1	0	0	0	0	0	0
3	Dibër	2	2	12	1	1	3	9	1	3	0	1	0	4	5	0	1
4	Durrës	3	4	5	1	0	2	5	1	2	2	2	0	0	1	0	0
5	Elbasan	3	0	11	4	6	1	6	2	5	3	8	1	5	1	1	5
6	Fier	8	3	17	1	6	2	6	1	0	4	1	0	0	1	0	1
7	Vlorë	1	5	1	1	0	1	0	1	1	2	4	1	3	2	1	2
8	Korçë	0	0	4	0	0	0	2	0	0	1	0	0	0	0	0	0
9	Kukës	6	3	5	0	6	4	2	1	6	5	1	0	2	3	2	1
10	Lezhë	10	8	1	1	1	2	0	0	4	2	2	0	1	1	0	0
11	Shkodër	10	3	6	4	0	1	0	3	6	0	5	0	6	1	1	0
12	Gjirokastrë	3	3	2	2	2	1	0	0	0	0	1	0	4	0	0	0
Total		50	33	65	16	27	19	32	11	30	22	30	2	27	15	5	10

VI. Statistika nga pyetsorët

Vlerësimi i nivelit të njohurive për IPARD II:

- 81 pjesmarrës kishin mjaftueshëm njohuri dhe;
- 63 prej tyre ishin të mirë informuar;

Informacioni shtesë që nevojitet t'u ofrohet të të interesuarve:

- 117 të interesuar për asistencën në mënyrën e aplikimit;
- 77 për kriteret e pranueshmërisë së aplikantëve;
- 76 për llojin e investimeve të mbështetura

Mënyra e preferuar për të marrë informacionin për thirrjet:

- 119 të interesuar për ditë informimi / seminare;
- 113 për publikime në internet.

VII. Aktivitetet promovuese për fushatën e informimit

Shpërndarja e materialeve të printuara për fushatën e informimit

- 980 GfA, 30000 fletëpalosje, 840 postera; 3 000 fletëvolante ; 2 roll-up dhe 1 baner.

Website IPARD II :

MBZHR - <http://bujqesia.gov.al/programi-per-bujqesine-dhe-zhvillimin-rural-ipard-ii/>

Agjencia IPARD - <http://azhbr.gov.al/programi-per-bujqesine-dhe-zhvillimin-rural-ipard-ii/>

Materialet e publikuara në web:

- Programi IPARD II;
- Njoftimi paraprak;
- Udhëzuesi për aplikantët së bashku me anekset;
- Takimet gjatë fushatës informuese;
- Lista e detajuar me kontakte për konsulentë/këshillues për IPARD;
- Seksioni Pyetje dhe Përgjigje (FAQ)

Transmetimi në TV and radio:

- TV Kombëtare: 3 stacione TV kombëtare;
- TV rajonale: 4 stacione lokale Televizive;
- Radio : 2 stacione radio kombëtare.

Trajnime të realizuara në kuadër të programit IPARD II:

- MBZHR me mbështetjen e GIZ, ka organizuar 5 module trajnimi prej 5 ditësh (22 Tetor - 2 Nëntor 2018 si dhe 4 - 9 nëntor 2018) me një total pjesëmarrësish prej 155 persona.

VIII. Rekomandime/ mësimet e nxjerra

- Ndërveprimi direkt me grupet e synuara si dhe takime të rregullta informuese për të gjithë palët e interesuara;
- Komunikimi i aktiviteteve në media (TV dhe radio).
- Fushata në media sociale dhe online;
- Krijimi i lehtësirave për të përfutur lejen e ndërtimit.
- Më shumë informacion lidhur me ekspertët ose këshillues të kualifikuar;
- Informacion lidhur me fondin e garancisë (para-financimin për investime në mënyrë që të përfitohet kolateral për kredi).



Faleminderit!